

VENDIM
Nr.131, datë 2.12.2008

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR DHËNIEN E STATUSIT TË KLIENTIT TË KUALIFIKUAR SHOQËRISË “ANTEA CEMENT” SHA PËR OBJEKTIN FABRIKA E ÇIMENTOS PRANË BURIZANËS, KRUIJË

Në mbështetje të neneve 9 dhe 48 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar dhe nenit 5, pika 2 të “Rregullores për kriteret e dhënies dhe heqjes së statusit të klientit të kualifikuar”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.99, datë 27.12.2006, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 2.12.2008, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Antea Cement” sh.a., për marrjen e statusit të klientit të kualifikuar për objektin fabrika e çimentos pranë Burizanës, Krujë.

Konstatoi se:

Aplikimi plotëson kërkesat e rregullores për kriteret e dhënies dhe heqjes së statusit të klientit të kualifikuar dhe vendimit nr.77, datë 14.12.2007 të Bordit të Komisionerëve “Për miratimin e nivelit të konsumit vjetor për përfitimin e statusit të klientit të kualifikuar”.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për dhënie të statusit të klientit të kualifikuar shoqërisë “Antea Cement” sh.a., për objektin fabrika e çimentos pranë Burizanës, Krujë.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta